



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2024:149462

Datë: 05.08.2024

Numri i dokumentit: 06017692

2024:149463

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit, Nd.nr.25/24 të datës 25.07.2024 e lidhur në zyrën e ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit A.L nga Kaçaniku dhe përfaqësueses së të dëmtuarës ... Shpk, V. S. nga Podujeva, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.706/24 të dt. 22.05.2024, për shkak të veprës penale, Keqpërdorim i besimit nga neni 330 par.1 të KPRK-së, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, më datën 05.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr.25/24 të datës 25.07.2024, e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit A.L nga Kaçaniku dhe përfaqësueses së të dëmtuarës, ... Shpk, V. S. nga Podujeva.

HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.706/24 e dt. 22.05.2024 dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurit A.L nga Kaçaniku, rr.”...” pn, i lindur me datë ..., me nr. personal: ..., për shkak të veprës penale, Keqpërdorim i besimit nga neni 330 par.1 të KPRK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën, PP/II.nr.706/24 të dt. 22.05.2024, e ka akuzuar të pandehurin A.L nga Kaçaniku, për shkak të veprës penale, Keqpërdorim i besimit nga neni 330 par.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të datës 24.07.2024, palët në procedurë janë pajtuar që lënda penale e evidentuar si 2024:149463, të procedohet sipas procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata duke vepruar konform, nenit 8 par.3 të Ligjit për Ndërmjetësim vendosi që çështja të dërgohet në Zyrën e Ndërmjetësimit.

Me datën 25.07.2024, në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, është arritur marrëveshja ndërmjetësimit, Nd.nr.25/24, në mes palëve në procedurë dhe atë të pandehurit A.L dhe dhe përfaqësueses së të dëmtuarës, ..., V.S nga Podujeva.

Andaj, Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovoi këtë Marrëveshje, pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

2024:149463 datë, 05.08.2024

Sekretarja Juridike

Indira Beqa

Gjyqtarja,

Zajrete Muhaxheri

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë ne afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.